

Thirrje për ofrues shërbimi jurist

Pozicioni:	Ekspert i jashtëm jurist për ofrimin e shërbimit ligjor
Projekti:	Sigurimi i aksesit në drejtësi dhe shërbime të ndihmës juridike falas për individët në situata vulnerabël që ndodhen në zonat rurale të Bashkisë Tiranë
Bashkia:	Tiranë
Kohëzgjatja e projektit	01 Janar – 31 Dhjetor 2023
Lloji i kontratës	Kontratë Shërbimi
Data e fillimit të punës	01 Shkurt 2023

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontrakttojë një shërbim ofrues jurist/e që të ofrojë shërbime ligjore cilësore për të gjithë personat e identifikuar në nevojë për këtë lloj shërbimi, në kuadër të projektit “Sigurimi i aksesit në drejtësi dhe shërbime të ndihmës juridike falas për individët në situata vulnerabël që ndodhen në zonat rurale të Bashkisë Tiranë”, në zbatim të programit “Zgjerimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri” financiar nga bashkëpunimi Austriak për Zhvillim dhe zbatuar nga PNUD në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë.

Rreth Nisma ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht Nisma) është një organizatë jofitimprurëse e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. Nisma është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i Nisma është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Nisma advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Rreth projektit

Ky projekt synon të ofrojë këshillim ligjor, të ndajë informacione në lidhje me mënyrat e referimit për të ndjekur të drejta të barabarta, duke ofruar shërbime të ndihmës juridike lëvizëse dhe mbështetje paraligjore. Fuqizimi i grave dhe vajzave për të ndjekur të drejta të barabarta, veçanërisht ato që jetojnë në zonat rurale, me arsim të ulët, në një situatë të vështirë socio-ekonomike. Gjithashtu, organizimi i iniciativave për adresimin e barrierave ligjore për aksesin në drejtësi.

Projekti synon të:

- Të vlerësojë dhe të rrisë ndërgjegjësimin për llojet e ndryshme të barrierave për aksesin në drejtësi dhe gjykata për grupet vulnerabël, dhe për mënyrat për të adresuar ato pengesa;
- Menaxhim i rasteve - jep një shembull të vlefshëm për gjyqtarët, avokatët, organizatat e shoqërisë civile dhe të tjerët në rritjen e aksesit në drejtësi dhe gjykata për personat që u përkasin grupeve të cënueshme, duke inkurajuar kështu zbatimin praktik të të drejtave;
- Sigurim i këshillimit ligjor, shkëmbimi i informacionit në lidhje me mënyrat e referimit për të ndjekur të drejta të barabarta,
- Ofrim i shërbimit të ndihmës juridike lëvizëse dhe mbështetje paraligjore.

- Fuqizimi i grave dhe vajzave për të ndjekur të drejta të barabarta, veçanërisht ato që jetojnë në zonat rurale, viktima të dhunës ose me arsim të ulët dhe në një situatë të vështirë socio-ekonomike.
- Organizimi i iniciativave për adresimin e barrierave ligjore në aksesin në drejtësi.

Grupet përfituese:

- Qytetarë të grupeve vulnerabël në Njësitë Administrative Fresku, Kashar, Vaqarr, Yzberisht, Ndroq, Farkë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Roli dhe përgjegjësitë e shërbimit ofruesit jurist do të fokusohen në:

- Krijimin e infrastrukturës që mbështet përpjekjet e vazhdueshme për akses në drejtësi;
- Sigurimi i mbikëqyrjes dhe menaxhimit të rasteve me çështje ligjore të patrajtuara më parë për individë/qytetarë;
- Organizimi i sesioneve të informacionit mbi legjislacionin në formë individuale apo në grup sipas nevojave të qytetarëve siç identifikohen përmes kontaktit, diskutimeve në fokus grupe ose aktivitete të tjera;
- Të ofrojë këshillim individual për qytetarët me nevoja ligjore imediate të identifikuara nga ekipi ose të referuara nga aktorë të tjerë, veçanërisht për çështje ligjore;
- Të sigurojë përfaqësim të drejtpërdrejtë ligjor për individët/qytetarët;
- Sigurimin, trajtimin dhe ndjekjen e nevojave ligjore për qytetarët e targetuar nga ky projekt;
- Ndjekja e procedurave sipas ligjeve në fuqi për të gjitha çështjet e mbrojtjes nga dhuna për çdo individ, grua, fëmijë, i/e rritur, si në kushtet e madhënieve familjare dhe më tej;
- Përgatitjen e materialeve orientuese, këshilluese (fletë palosje) për të gjitha çështjet e identifikuara nga vlerësimi i nevojave;
- Organizimi i sesioneve këshilluese dhe ndërgjegjësuese për qytetarët në nivelin bazë të njohurive ligjore për të drejtat dhe detyrimet e tyre;
- Raportimin e rasteve në nevojë për mbrojtje si fëmijë apo rritur (raste të identifikuara gjatë aktiviteteve apo punës në terren me vëmendje të shtuar ndaj rasteve të dhunës në madhëniat familjare);
- Prodhimin e një raporti që përmban rekomandime për të rritur efikasitetin, sigurinë, planfikimin dhe zbatimin e tyre në operacionet e tyre të përditshme;
- Eksperti do të angazhohet si ofrues i shërbimeve për 12 muaj në aktivitetet e lidhura me projekti.

Kualifikime dhe eksperiencia e punës:

- Diplomë universitare dhe master shkencor në shkencat juridike;
- Njohuri dhe kualifikime që lidhen me çështje të emigracionit (për fëmijë dhe të rritur);
- Njohuri dhe kualifikime që lidhen me çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe grave;
- Njohuri shumë të mira të paketës ligjore të shërbimeve shoqërore;
- Përvojë të punës në ekip për koordinimin e veprimeve për realizimin e planeve të ndërhyrjes ndaj individëve në nevojë;
- Aftësi për të punuara në mënyrë të pavarur dhe të përshtaten sipas nevojave të punës në grup;

- Dëshirë dhe mundësi për të udhëtuar në terren dhe për të punuar me kategoritë vulnerabël;
- Të jenë të gatshëm për të filluar punë menjëherë;
- Të përgjigjet në kohë rasteve të referuara;
- Aftësi të mbledhë, analizojë dhe përpunojnë të dhënat me vëmendje në detaje dhe saktësi
- Kërkojnë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze në të folur, lexuar dhe shkruar;
- Aftësi shumë të mira në përdorimin e paketës MS Office
- Të kuptojë dhe të dakordësojë me misionin dhe qëllimin e Nisma ARSIS, Politikat e Mbrojtjes dhe të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri;

Politikat e Mbrojtjes: Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, kodin e sjelljes bashkëngjitur me termat e referencës.

Koha e mundshme e fillimit të punës është 01 shkurt 2023.

Procedura e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e juristit duhet të dërgojnë me email:

- 1- Shprehje interesi;
- 2- Curriculum Vitae (evidence të punëve të mëparshme të ngjashme);
- 3- Ofertë financiare.

Gjithë dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet në adresën e emailit: initiative.arsis@gmail.com ose pranë zyrave të Nisma “Rruga Sali Butka”, Pallati T.B.M, Ap.1”, në zarf të mbyllur me emrin e projektit deri në datën 22.01.2023, mesnatë, me subjekt: Aplikimi për “Jurist pranë NISMA ARSIS”

Përzgjedhja e ekspertit do të bazohet në:

- Sa mirë i plotëson aplikacioni kërkesat e përcaktuara në Termat e Referencës.
- Përvojë përkatëse.
- Oferta financiare
- Regjistrimi tatimor (I preferueshëm)

Vetëm kandidatës e përzgjedhur për fazën e intervistimit për pozicionin e juristit do të kontaktohen.